



Republika e Kosovës

Komuna e Vushtrri

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

K R I T E R E T

Për shpalljen e "Sportisti i vitit 2023"

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Vushtrrisë bënë shpalljen e më të mirëve si: Sportistin e vitit, Klubin Sportiv më të suksesshëm, Trajnerin më të mirë, Referin më të mirë, Punëtorin Sportiv, Gazetarin Sportiv, Shpresat e vitit, ndarja e mirënjohjeve për mediat për kontributin e dhënë në zhvillimin dhe masovizimin e sportit.

Komisionit duhet ti paraqiten propozimet nga Klubet Sportive me arsyetime për secilin propozim të bërë, nga data 16.1.2024 deri me datë 26.1.2024

Komisioni për shpalljen e sportistëve më të mirë për vitin 2023 duhet të u përmbahën KRITEREVE të poshtëshenuara:

1. Sportist i vitit mund të shpallët ai sportist i cili:
 - a) Ka paraqitje kulminante, cilësore dhe të ketë arritje të larta individuale apo me klub,
 - 1.Ndërkombëtare,
 - 2.Kombëtare,
 - 3.Nacionale,
 - 4.Rajonale.
 - b) Klubi i cili është paraqitur të ketë arritur suksese gjatë vitit kalendarik 2023, në garat ndërkombëtare apo vendore.
 - c) Të ketë paraqitje standarde dhe numër të madh të paraqitjeve me klubë, të jetë anëtar/e e reprezentacionit të shtetit.
 - d) Të jetë i dicitplnuar, i sjellshëm në kuadër të klubit ku është i/e inkuadruar.

2. Klubi sportiv i vitit mund të shpallet:

- a) Klubi sportiv i cili në arenën ndërkombëtare ka arritur suksese
- b) Klubi sportiv i cili në arenën vendore ka arritje të larta
- c) Rangu i garave ku klubi sportiv garon
- d) Masoviteti i garave
- e) Organizimi i Klubit.

Vërejtje: Nëse Komisioni për Shpalljen e Sportistit të vitit, vëren se në aplikacione ka informata të pa sakta dhe të fryera nga kushdo, do të kërkojnë sqarime shtesë, po ashtu nëse ndonjë lojtar që ka arritje të mira dhe nuk është propozuar nga klubi, komisioni do të kërkojë nga klubi dhe institucionet tjera informata të tjera shtesë që të përfshijë në listë atë sportist/e.

Kriteret e lartëshenuara për sportistin dhe klubet sportive vlejnë edhe me rastin e shpalljes së më të mirëve edhe të “Shpresat e vitit”, “Punëtori Sportiv i vitit”, “Trajneri i vitit”, “Pedagogu i vitit” dhe “Gazetari Sportiv”.

Të gjitha materialet dorzohen në arkivë në pliko të mbyllur dhe nuk hapen deri në mbledhjen e komisionit.

Medina Bunjaku

Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport

